



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:161348

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05703440

KA.nr.466/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Auto Salloni Ridi” ShPK me NUI 810513649 dhe seli në Çagllavicë në Prishtinë, i cili përfaqësohet nga avokati Ibrahim Shala me seli në Gllogoc, kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 18.04.2024 në të cilën morën pjesë të dy palët, më 2 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit “Auto Salloni Ridi” ShPK me NUI 810513649 kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës me seli në Prishtinë, në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin vendimit FIUAD: 149/2020 të datës 27.08.2020.
- II. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit “Auto Salloni Ridi” ShPK me NUI 810513649 kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit FIUAD:204/2020 të datës 22.10.2020 të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të i padituri.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadija dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 19.11.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit FIUAD: 149/2020 të datës 27.08.2020 dhe FIUAD:204/2020 të datës 22.10.2020 të së paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës me seli në Prishtinë.
2. Paditësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se gjendja faktike në vendimet e goditura nuk është e saktë sepse nuk ka pranuar ftesën për këshillim ndërkaq edhe me rrethanat e pandemisë COVID 19 ka pasur restriksione sfiduese që e

kanë penguar kryerjen e punës normale të secilit subjekt. Ka shtuar se, e vendimet nuk e kanë përmbajtjen me konditat thelbësore esenciale që një vendim të jetë i bazuar në ligj si dhe të jetë i drejtë, por edhe vet konstaton se nuk ka hasur në ndryshime dhe nuk ka një raport me të gjeturat se subjekti raportues Auto Salloni Ridi të ketë fshehur dimensionet afariste të punës së vetë, të ketë të lidhur ndonjë kontratë apo punë juridike nga fushë veprimtaria e afarizmit të vetë nga personat e dyshimtë apo me të kaluar kriminale, respektivisht nuk ka pasur rast që është më se reale por edhe që vetë e paditura ka konstatuar që ky subjekt raportues të ketë pasur transaksione me persona politik si gjithë çfarë i është kërkuar në mënyrë më korrekte dhe juridike dhe me një kulturë juridike e shoqëruar me performancë të lartë i ka ofruar faturat, kontratat për transaksionet lidhur me shitjen e automjeteve, mirëpo diçka që është konsideruar nga e paditura si e munguar ajo është lidhur për të pasur fotokopjet e personave të letërnjoftimeve apo të pasaportave. Sipas tij, një praktike e tillë është shkrirë prej këtyre dokumenteve përkatëse në përmbajtjen e plotë në fatura dhe kontrata, prandaj një lëshim i tillë edhe në praktikën e mëtutjeshme ka mundur lehtë të eliminohet.

3. Përveç kësaj, ka deklaruar se ka shkuar tek e paditura dhe për të realizuar takimin për marrje të këshillave, sugjerimeve apo edhe të vërejtjeve eventuale mirëpo për shkak se kanë qenë masat e COVID 19 nuk ka pas realizim të kontaktit sepse nuk ka gjetur inspektorat përkatës. Ka shtuar se ka pasur procedurë të shkruar të identifikimit të klientëve gjë që nuk qëndron pasi të gjitha shënimet janë në fatura dhe kontrata, konstatimi se nuk ka pasur procedurë të identifikimit të kontratës po ashtu nuk qëndron sepse nga themelimi i kompanisë e tutje asnjë person me pozitë politike nuk ka qenë klient te paditësi.
4. Për fund ka shtuar se ai asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin në veprimtarinë e vet afariste, dhe ka shtuar se vendimet e të dy instancave vendimmarrëse administrative nuk e legjitimojnë dhe e justifikojnë përmasat dhe dimensionet e gjendjes faktike. Për më tepër as nuk korrespondojnë në përcaktimet e klasifikimit të aplikimit të ndëshkimeve administrative sikur nga e paditura që janë aplikuar dhe këtë e konsiderojmë përtej çdo ndryshimi se meqenëse në kontrata dhe transaksione të shitblerjes së automjeteve, me klientë dhe persona nuk janë hasur konstatime dhe nuk është vërtetuar se pranë këtij subjekti raportues është vërtetuar ndonjë akt terrorist shpëlarjes së parave dhe personave të ekspozuar politikisht gjithnjë nga neni 2 par.1 nënpar.1.1, pastaj transaksionet të dyshimta nga po i njëjti nen nënpar 1.2 nuk janë gjetur dhe për faktin vendimet se të

gjeturat nga ana e të paditurës tek paditësja sa i përket azhurimit të evidencave, dokumentacionit të klientëve pa ju krijuar një kartotekë të lejeve të njoftimit me gjithë këtë konsiderojmë se të gjitha të dhënat dhe specifikimi i të gjetura kanë qenë të përmbajtura edhe në kontrata dypalëshe dhe në fatura duke e përfshirë shënimet e nevojshme sa i përket të dhënave për automjetin dhe blerës. Mbi këtë bazë rrethanave që kanë mbretëruar rrethanave të ditura botërisht COVID 19 ka pas mos qartësi në zbatueshmëri të ligjit dhe të akteve nënligjore, megjithatë nga klasifikimi i ndëshkimeve administrative këto shkelje edhe pse qartësisht kanë ekzistuar sa i përket dërgimit si subjekt raportues të raportit të fushë veprimtarisë të paditëses dhe evidentimit të dokumentacionit në mënyrë të veçantë nuk përbën shkelje shumë të rënda. Por nga fakti se paditësja ka qenë kooperative në respektim të autoriteti të Inteligjencës Financiare të Kosovës, konsideroj shkeljet nuk kanë qenë as përmasave as të dimensioneve që të shkohet në një dënim të tillë kur shkelja ka ndodhë për herë të parë. Sipas tij, shkeljet nga neni 41, ndërkaq ndëshkimi nga neni 42 është interpretuar nga pozita monopoliste dhe nëpërmjet deformimit procedural administrativ sepse ka pas mundësi të interpretohet drejtë dhe të jepet vërejtja publike.

5. I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Sipas tij, bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 05/L-096 për PPP/LFT ka realizuar inspektimin në vend tek paditësi ku gjatë inspektimit sipas proceduarve të brendshme është mbajtur procesverbal ku janë evidentuar të gjitha gjetjet dhe mangësitë e identifikuar, si dhe procesverbali është nënshkruar nga të dyja palët. Tutje, me qëllim sqarim të gjeturave e paditura ka përcjellë kërkesën për sqarim tek paditësi me ç ‘rast ka njoftuar për shkelje të evidentuara duke i dhënë mundësinë paditësit që në afat prej dy javësh të ofron me shkrim observimet tij. Lidhur me pretendimin se i padituri nuk ka kontaktuar me paditësin ky pretendim nuk qëndron sepse i njëjti nuk ka vepruar në harmoni me kërkesën për sqarim, andaj i padituri duke vepruar në harmoni me para. 6 të nenit 48 të ligjit PPP/LFT ka marrë vendimin FIUARD 149/2020 të datës 27.08.2020 për shqiptimin e sanksionit administrativ. Përveç kësaj, pala ka ushtruar ankesë në shkallën e dytë e cila është refuzuar si a pabazuar pasi që nuk është ofruar asnjë provë e cila do të mund të ndryshonte mënyrën e vendosjes. Sipas tij, ai ka ofruar trajnim për subjektin të cilin nuk i janë përgjigjur, po ashtu ka konstatuar se dispozitat ligjore të PPP/LFT nuk janë respektuar siç janë raportimi, identifikimi i personave të ekspozuar politikisht, marrja e

dokumentacionit, mbajtja e të dhënave etj., andaj në këtë situatë ka shqiptuar minimumin e ndëshkimit administrativ për këto shkelje. Sa i përket lartësisë së dënimit, ka sqaruar se për shkeljet e konstatuara NJIF ka shqiptuar minimumin e gjobës së paraparë për shkeljet e identifikuar dhe përcaktuara në nenin 41 të ligjit PPP/LFT, ku ligji për më tepër përcakton se ndëshkimi është i detyrueshëm në të gjitha rastet. Ka shtuar se me shumë kujdes ka trajtuar edhe raportin e rishikimit nga auditori i pavarur për pasqyra financiare për vitin 2019 të paditësit ku subjekti tregon pozitë të qëndrueshme financiar, andaj komisioni i shkallës së dytë ka konstatuar se shkalla e parë gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ ka marr në konsideratë të gjitha rrethanat relevante të përcaktuara në par.2 të nenit 49 të ligjit PPP/LFT dhe për shkeljet e evidentuara ka shqiptuar minimumin e ndëshkimit administrativ të paraparë me ligj.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

6. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e provave. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër FIUAD:204/20 i datës 22.10.2020 i NJIF-K; ankesa e datës 24.09.2020 e paditësit të NJIF-K; raporti i shkurtë preliminarë në emër të paditësit për periudhën kohore 01.09.2020-19.11.2020 pa numër dhe datë i hartuar nga vetë paditësi; deklarata e shkruar me dorë nga R.C. e datës 18.11.2020; procesverbali i inspektimit të pajtueshmërisë i datës 20.02.2020; pasqyra financiare në emër të paditësit për vitin 2019 i hartuar nga vetë paditësi, si dhe komplet shkresat e lëndës të procedurës administrative të dërguara nga i padituri me përgjigjen në padi.
7. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se i Padituri më 20.02.2020 me paralajmërim paraprak e kishte inspektuar lokalitë e Paditësit me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Ligjin 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit (këtu e tutje LPPPLFT).
8. Pas inspektimit, më 03.07.2020 i Padituri përmes parashtresës e ka njoftuar Paditësin se në bazë të inspektimit ka konstatuar se: (i) Paditësi nuk ka rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, siç kërkon neni 17 i LPPPLFT-së, (ii) nuk ka raportuar transaksione të realizuara në para të gatshme në vlerë prej mbi 10,000.00€, (iii) nuk posedon listën e indikatorëve të hartuara nga NjIF-K për identifikimin e personave dhe

transaksioneve për të cilët ka arsye për të dyshuar për pastrimin të parave, financim të terrorizmit ose veprat e ndërlidhura penale, (iv) nuk e ka përcaktuar në mënyrë periodike rrezikun për pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, (v) nuk e ka bërë identifikimin e personave të ekspozuar politikisht, si dhe (vi) shumë dosje janë të pakompletuara, disave ju mungon kopja e dokumentit identifikues e në disa dosje dëshmia e pagesës. Njëherësh e ka ftuar Paditësin që brenda 2 javëve të jap sqarime me shkrim lidhur me observimet e tij në raport me gjetet e prezantuara në atë shkresë.

9. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë nga e cilat do të rezultonte se i ka paraqitur të Paditurit përgjigje në shkresën e cekur më lartë. Për më tepër, Paditësi nuk e ka ngritur asnjë pretendim se brenda afatit prej 2 javëve i ka paraqitur sqarimet e kërkuara.
10. I Padituri më 27.08.2020 ka nxjerr vendimin FIUAD 149/2020, me të cilin i Paditësit i ka shqiptuar gjobë në lartësi prej 50,000.00€ dhe vërejtje publike për shkelje shumë të rënda nga neni 41 para. 1 nënpara. 1 dhe për shkelje të rëndë administrative nga 43 para. 1 nënpara. 1, 7, 9 dhe 13 të LPPPLFT-së. Shqiptimin e gjobës dhe vërejtjes i Padituri e kishte arsyetuar me shkeljet e paraqitura në kërkesën e cekur më lartë për sqarim. Lidhur me lartësinë e gjobës, i Padituri kishte arsyetuar se i ka marrë për bazë rrethanat nga neni 49 para. 2 i LPPPLFT, rrjedhimisht ka shqiptuar gjobën sipas minimumit të përcaktuar për shkeljet e rënda administrative.
11. Paditësi më 25.09.2020 kishte ushtruar ankesën ndaj vendimit të cekur më lartë, ndërsa më 22.10.2020 i Padituri e kishte nxjerr vendimin FIUAD:204/2020, me të cilin e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka vërtetuar vendimi FIUAD:149/2020 të datës. 27.08.2020. Në atë vendim, i Padituri i kishte përkrahur gjetet dhe arsyet e vendimit të vërtetuar.
12. Në shkresat e lëndës nuk ka prova, nga të cilat do të rezultonte se janë të gabueshme ose jo të sakta gjetjet e të Paditurit lidhur me shkeljet e Paditësit. Në këtë drejtim gjykata sqaron se në bazë të nenit 322 para. 2 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së Paditësi e ka barrën e provës për të vërtetuar se gjendja faktike gjatë procedurës administrative nuk është konstatuar në mënyrë të plotë ose është konstatuar në mënyrë të gabuar, procedura administrative është zbatuar në kundërshtim me dispozitat ligjore që i rregullojnë veprimet procedurale përkatëse, si dhe e drejta material është zbatuar gabimisht nga autoritetit publik, në këtë rast i Padituri.

13. Nga provat tjera në shkresat e lëndës vërtetohen edhe fakte tjera, të cilat nuk janë relevante për zgjidhjen e çështjes, rrjedhimisht gjykata nuk i elaboroi në këtë aktgjykim.

III. Vlerësimi meritor i rastit

14. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit me të cilën është goditur vendimi FIUAD: 149/2020 të datës 27.08.2020 dhe gjeti se ajo është e palejueshme.
15. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.
16. Në rastin konkret, vendimi FIUAD: 149/2020 i datës 27.08.2020 është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur”*.
17. Prandaj, për këtë gjykatë padia e Paditësit me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
18. Në lidhje me kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e vendimit administrativ nr.10/K-FIUAD: 149/2020 të datës 27.08.2020 të së Paditurit, gjykata pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të ndërgjyqësve, provave të administruara dhe të analizuara në kuptim të

nenit 8 të LPK-së, si dhe analizimit të dispozitave juridike relevante gjeti se kërkesëpadia e është e bazuar.

19. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat e veçanta procedurale të LPPPLFT-së. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47, 48 dhe 134 të LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
20. Përveç kësaj, gjykata konstaton se i Padituri e ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike.
21. Ligjërisht, gjendja faktike e përshkruar më lartë rregullohet me disa nene të LPPPLFT-së. Fillimisht, sipas nenit 16 para. 1.5 të LPPPLFT-së, Paditësi paraqet subjekt raportues, meqenëse që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë, siç kishte deklaruar ai gjatë inspektimit të datës 20.02.2020.
22. Sipas nenit 17 para. 2 të LPPPLFT-së “*Veprimet dhe masat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni ndërmerren nga të gjitha subjektet raportuese. Për këtë qëllim, subjektet raportuese nxjerrin rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, vendosin kontrole për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe i zbatojnë ato (...)*”. Siç është sqaruar më lartë, Paditësi nuk ka sjellë prova që ka nxjerrë rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, rrjedhimisht gjykata gjen se ai kishte vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë juridike.
23. Neni 18 para. 2 i LPPPLFT-së ka përcaktuar se “*Të gjitha subjektet raportuese përcaktojnë në mënyrë periodike rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilit janë të ekspozuara gjatë ofrimit të shërbimeve dhe produkteve të tyre, vendndodhjes gjeografike dhe mekanizmave e kanaleve të shpërndarjes. Vlerësimi i rrezikut u shpërndahet me kërkesë të NjIF-K dhe, për bankat dhe institucionet financiare, edhe BQK-së*”. Siç është konstatuar më lartë, i Padituri kishte gjet se ka shkelje të kësaj dispozite juridike, ndërsa Paditësi nuk ka sjellë asnjë provë nga e cila rrjedh se e ka përmbushur detyrimin nga kjo dispozitë.

24. Përveç kësaj, sipas nenit 20 të LPPPLFT-së “*Subjektet raportuese mbajnë të gjitha të dhënat për informatat e mbledhura në pajtim me këtë ligj dhe sigurojnë se dokumentacioni dhe informacionet përcjellëse të jenë të gatshme dhe në dispozicion të NjIF-K-së, si dhe autoriteteve të tjera kompetente: 1.1. kopjet e dokumenteve që dëshmojnë identitetin e klientit, mbajtëseve të së drejtës së pronës të marra në pajtim me këtë ligj, llogaritë e dosjeve dhe korrespondencën biznesore, për së paku pesë (5) vjetët e fundit, pas përfundimit të marrëdhënies biznesore; 1.2. informacionet e pranuar në përputhje me dispozitat këtij ligji, për të mundësuar rindërtimin e transaksioneve, që janë ekzekutuar ose është tentuar të ekzekutohen nga ana e klientëve, dhe raportet me shkrim të krijuara në përputhje me nenin 25 të këtij ligji, për së paku pesë (5) vjet pas tentimit për ekzekutim ose ekzekutimit të transaksionit; 1.3 kur të dhënat e transaksioneve i referohen një serie transaksionesh të ndërlidhura të kohëpaskohshme, periudha pesëvjeçare (5) e ruajtjes fillon me ekzekutimin e transaksionit të fundit në atë seri; 1.4. kur informacioni për transaksionin lidhet me një raport të dorëzuar në NjIF-K për sa i përket një akti apo transaksioni të dyshimtë, periudha pesë (5) vjeçare fillon nga data e dorëzimit të raportit në përputhje me nenin 26 të këtij ligji”*. Pra, ruajtja e dokumenteve në formën dhe kohën e caktuar është rregulluar në mënyrë obligative me LPPPLFT, ndërsa i Padituri në vendimin e tij kishte konstatuar se Paditësi e ka shkelur këtë detyrim, kurse Paditësi nuk ka paraqitur prova nga të cilat në gjykatë do të provohej se i ka ruajtur dokumentet konform nenit të sapo cituar.
25. Gjithashtu, sipas nenit 26 para. 1 nënpara. 2 të LPPPLFT-së “*1. Të gjitha subjektet raportuese raportojnë tek NjIF-K, sipas mënyrës dhe formës së specifikuar nga NjIF-K, si në vijim: (...) 1.2. të gjitha transaksionet individuale në para të gatshme në vlerë dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë apo vlerës ekuivalente në valutë të huaj. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si një transaksion individual nëse subjekti raportues është në dijeni se transaksionet janë nga apo në emër të një personi ose subjekti dhe kapin vlerën dhjetëmijë (10.000) euro apo në shumë brenda një (1) ditë të vetme”*. Paditësi nuk ka paraqitur prova se i ka raportuar NjIF-së rastet kur ka realizuar shitje në para të gatshme në shumë prej mbi 10,000.00€, rrjedhimisht gjykata konstaton se Paditësi e ka shkelur këtë normë ligjore.
26. Shkelja nga neni 26 i LPPPLFT-së kategorizohet si shkelje shumë e rëndës sipas nenit 41 para. 1 nënpara. 1, sipas të cilit “*Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim do të përbëjnë shkelje shumë të rënda: 1.1. dështimi për të përmbushur detyrimet e raportimit*

të përcaktuara në nenin 26”, ndërsa shkeljet tjera kategorizohen si shkelje të rënda të parapara me nenin 43 para. 1.1, 1.7, 1.9 dhe 1.13 të LPPPLFT-së, sipas të cilëve “Shkeljet e dispozitave të këtij ligji si në vijim paraqesin shkelje të rënda: 1.1. dështimi në përputhje me detyrimin që të nxirren politika dhe procedura të brendshme të shkruara në vendosjen kontrolleve për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në zbatimin e tyre siç përcaktohet në nenin 17 të këtij ligji; (...) 1.7. mospërbushja e detyrimit të aplikimit të masave të kujdesit të duhur të shtuar, siç përcaktohet në nenin 22 të këtij ligji; (...) 1.9. dështimi në përputhje me detyrimin e vlerësimit të rrezikut, siç përcaktohet në nenin 18 të këtij ligji; (...) 1.13. mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen e të dhënave, siç përcaktohet në nenin 20 të këtij ligji;”

27. Pasojat juridike të shkeljeve të rënda janë paraparë në nenin 42 para. 1 të LPPPLFT-së, sipas të cilit NjIF-K ka të drejtë të shqiptoj vërejtje publike dhe gjobë. Ngjashëm edhe me nenin 44 para. 1 të LPPPLFT-së. Siç rrjedh nga vendimi i shkallës së dytë, i Padituri me rastin e shqiptimit të sanksionit administrativ i ka marrë parasysh dhe i ka arsyetuar të gjitha kërkesat nga neni 49 para. 2 i LPPPLFT-së lidhur me përcaktimin e ndëshkimit administrativ. Në këtë drejtim, gjykata e sheh të nevojshme të sqaroj se si nenit 42 para. 1 i LPPPLFT-së për shkeljet shumë të rënda ashtu edhe neni 44 para. 1 i LPPPLFT-së për shkeljet e rënda e kanë paraparë mundësinë që NjIF-K të shqiptoj vetëm vërejtje publike, megjithatë duke e marrë parasysh vëllimin dhe llojet e shkeljeve të konstatuara nga i Padituri, gjykata i vlerëson si proporcionale ndëshkimet e shqiptuara.
28. Gjukata i pati parasysh edhe pretendimet tjera të Paditësit, por gjeti se ato nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.
29. Për arsyet e cekura më lartë gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i Padituri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore neni 52 i LPPA-së ose neni 16 i LKA-së që ai të anulohet, për pasoj e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e Paditësit lidhur me vendimin e shkallës së dytë të së Paditurit.

30. Prandaj, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.466/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.